

K.U.D 32 (496.5) "1920/1924"  
94 (4965). 086

Prof. ass. dr. Teki KURTI

### **QEVERISJA VENDORE NGA KËNDVËSHTRIMI I VEPRIMTARISË PARLAMENTARE GJATË VITEVE 1920-1924 NË SHQIPËRI**

Analiza e qeverisjes vendore nga këndvështrimi i veprimtarisë parlamentare ka rëndësi të veçantë për kuptimin e vendit e të rolit të kësaj qeverisjeje.

Një analizë e tillë është më se e domosdoshme në vendet me sistem qeverisjeje të demokracisë liberale, nga që funksionon nëpërmjet qeverisjes përfaqësuese e realizuar në radhë të parë në parlament. Përfaqësuesit në parlament janë "të deleguar" të zonave apo krahinave të administruara edhe nga organet e qeverisjes vendore.

"Modeli" i deputetit si "delegat" i të qeverisurve zinte vend të dukshëm në kuadrin e shteteve liberale e konstitucionaliste, ku zhvillimi i partive politike ishte i shkallës së ulët dhe në fillimet e zbatimit të funksioneve të tyre.

Dihet se me zhvillimin dhe konsolidimin e partive politike bëhet mbizotërues modeli i deputetit me "mandat partie", i cili e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të programit dhe të orientimeve partiake.

Shkalla e pamjaftueshme në zhvillimin e partive politike, në rrethanat edhe të fillimit të jetës parlamentare, pra, ende pa struktura të mirëkonsoliduara të veprimtarisë parlamentare, pasqyrohet edhe në shkallën e ndikimit edhe në veprimtarinë e qeverisjes vendore.

Nga studimi i një materiali të gjerë të dokumentuar për punimet e legjislativave gjatë viteve 1920, dhe në vitet 1930, mund të arrijmë në disa përfundime:

1. Në punimet e legjislativave kanë zënë vend të dukshëm diskutimet dhe rrahja e mendimeve për gjendjen e rendit, të sigurisë si të asaj ekonomike e sociale të prefekturave dhe komunave.

2. Deputetët kanë qenë nismëtarë për shtrimin e problemeve, të propozimeve dhe kërkesave për zgjidhje. Madje ata kanë afruar mënyra dhe rrugë për zgjidhje.

3. Veprimtaria e deputetëve është rritur edhe më shumë nëpërmjet përpjekjeve për të nxjerrë përgjegjësinë e qeverisë për gjendjen në krahinat vendore.

4. Qeveritë kanë dhënë shpjegime për politikën e ndërmarra. Madje ka qenë rregull si në Legjislativën e parë që kryeministri Ahmet Zogu të raportonte për veprimtarinë e kabinetit qeveritar në çdo dy muaj.<sup>1</sup>

Vlerësimi i veprimtarisë parlamentare edhe për qeverisjen vendore është i plotë dhe i saktë nga konsiderata si:

a. Motivët në formulimin e politikave dhe të vendimmarrjeve;

b. Synimet që duhej të realizoheshin nëpërmjet detyrë përmbushjeve të qeverisë;

c. Arritja e konsensusit dhe të kompromisit të domosdoshëm;

d. Përgjegjësia politike, ligjore e financiare për veprimtarinë e ndërmarra;

e. Kontrolli dhe llogaridhënia.

Është për t'u theksuar se përbën një moment kthese që nëpërmjet strategjisë qeverisëse i jepej përparësi konsolidimit të shtetit me anën e modernizimit të institucioneve dhe të zhvillimit ekonomik dhe social. A. Zogu në mbledhjen e IX-të të Këshillit Kombëtar, në mars të vitit 1923, shprehte pikërisht këtë strategji. "Në jetën e popullit shqiptar ndjenja patriotike është shumë më e fortë se kurrë – vinte në dukje ai. - Populli shqiptar, i cili deri në vitin 1913 nuk pati treguar entuziazëm për sa i përket çështjes së përparimit të shtetit të tij, sot është përfshirë me interes dhe zell në çështjet dhe problematikën që e shqetësojnë atë. Si në çdo vend tjetër edhe në Shqipëri ka filluar të ndihet një opinion apo gjykim për sa i përket mënyrës së qeverisjes.

Mendimi se populli shqiptar e do dhe di ta ruaj pavarësinë e vetëqeverisjes e tij politike e ekonomike, ka filluar të ekzistojë si në vendet e tjera".<sup>2</sup>

<sup>1</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, Legjislativa e parë, Sesioni i III, Mbledhja e IX, 17 Mars 1923, Tiranë, f. 113.

<sup>2</sup> Po aty, f. 114.

Vend të rëndësishëm në fjalimin e tij zinte uniteti që ekzistonte midis shqiptarëve. “Një nga kritikantët më të forta të armiqve të Shqipërisë – vazhdonte Zogu - ishte se Shqipëria nuk është në gjendje të qëndrojë e pavarur edhe pse ka një popull i cili ka fe e tradita të ndryshme, që nuk i lejojnë të bashkohen dhe, se po t’i jepet liri këtij kombi, ai nuk do të jetë në gjendje ta mbrojë atë.

Në veprimtarinë e kohëve të fundit, populli shqiptar e ka treguar se është i zoti të mbrojë lirinë e tij dhe të qeverisë që e drejton dhe, të jetojë vëllazërisht pa marrë parasysh ekzistencën e besimeve të ndryshme fetare”.<sup>3</sup>

Këto kanë shërbyer si bazë e fuqishme në zgjidhjen e problemeve ekonomike e sociale e mbi të gjitha që ligjet të mos jenë qëllim në vetvete, por të vlerësohen mbi bazën e efektshmërisë së tyre për arritjen e rezultateve konkrete në zhvillimin e vendit.

Debatet në parlament ndihmonin për zbardhjen e veprimtarisë të organeve të larta të qeverisjes së shtetit shqiptar. Ato përbëjnë një burim të rëndësishëm për kuptimin e karakterit dhe të përmbajtjes së politikave të ndërmarra nga qeverisja qendrore dhe ajo vendore.

Vend qendror në politikat shtetërore zuri synimi për arritjen e sigurisë, zbatimi i ligjit dhe vendosja e rendit. Për këtë është zhvilluar një veprimtari e madhe për pajtimin e gjaqeve. “Siguria në krahinat, - thotë A. Zogu, është cenuar nga “zakoni i lig që ka mbetur trashëgim që prej kohësh, ai i marrjes së gjakut”. Rrjedhojat e këtij zakoni për A. Zogun, ishin në shumë drejtime, si: Në angazhimin e qeverisë me forca ushtarake të cilat mund t’i përdorte në mënyrë të efektshme në drejtime të tjera; izolimin e banorëve dhe shkëputjen e tyre nga veprimtaria ekonomike, si punimi i tokës etj.

“Sot, - deklaronte Zogu, - kemi ardhur në një gjendje të mirë. Dikur, ata që i kërkonte gjyqi jo vetëm nuk dorëzoheshin, por nuk paraqiteshin as dëshmitarët. Sot, jo vetëm dëshmitarët, por edhe ata që e dinë saktësisht se do të dënohen, janë paraqitur”.<sup>4</sup>

Siguria lidhej edhe me sistemin e muhaxhirëve të shumtë, të cilët në mungesë të mjeteve për jetesë, prireshin për veprime në dëm të të tjerëve.

3 Po aty.

4 Po aty, f. 115.

Nërkohë, qeverisja qendrore është përballuar edhe me veprime rebeluese, si në krahinën e Krumës.

Problem qendror ishte funksionimi i administratës qendrore të qeverisjes në të gjithë vendin, e lidhur kjo edhe me zbatimin e ligjit në shkallë kombëtare.

Nëpër shumë vise të Shqipërisë, sipas A. Zogut, nuk mund t'u merreshin taksat qeveritare në sasinë e duhur dhe që shumë i shmangeshin pagesës së tyre.

Çështja shtrohej që të gjithë t'i nënshtroheshin zbatimit të ligjit e shlyerjes së taksave në bazë të ligjit.

Diskutimet janë përqendruar edhe për projekte konkrete për zhvillimin e ekonomisë, të arsimit e kulturës, në krahina të ndryshme të vendit.

Ato janë përqendruar kryesisht për buxhetin, pra të sigurimit të ardhurave të nevojshme për realizimin e shpenzimeve. Prandaj buxheti ka përbërë problemin parësor në këto diskutime. Me shumë rëndësi në drejtim të qeverisjes vendore janë vendimet e marra për ndërtimin e rrugëve urbane. Po ashtu në qendër të vëmendjes ka qenë zhvillimi i arsimit, me hapjen e gjimnazeve, të bibliotekave etj.

Diskutimet “zbulojnë” edhe raportin ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore.

Veprimtaria parlamentare në Shqipëri edhe në fillesat e saj shënoi hapa të rëndësishëm në realizimin e funksionit të parlamentit si organ debati e shqyrtimi të politikave.

Mendoj, se ky aspekt i rëndësishëm në qeverisje i ka shërbyer qeverisjes vendore. Mund të themi se qysh në legjislaturën e parë ekzistonte opozita, ndonëse jo aq e organizuar dhe me forcë të madhe ndikuese. Sidoqoftë, janë shquar deputetë të veçantë si: Luigj Gurakuqi, Haxhi Banka, Bari Omari, Ali Këlcyra, Fan Noli.

Opozita ka vepruar në rrethanat kur shumica që formonte qeverinë, mbizotëronte parlamentin. Megjithatë, janë shfaqur veçori që i shërbenin forcimit të jetës parlamentare si:

- Opozita është përpjekur të tregohet konstruktive.
- Veprimtaria e saj është vlerësuar mbi bazën e ndikimit për arritjen e rezultateve efektive në qeverisje.

Shumë kuptimplotë është fjalimi i mbajtur nga Luigj Gurakuqi: “Jam kundërshtar, por bazohem mbi të drejtën. Ne nuk vijmë këtu me

kritika në xhep për t'ia hedhur parlamentit në sy. Ne duam të japim mendimet tona ashtu si i ka hije një kundërshtari. Kundërshtar nuk do të thotë t'i themi të bardhës e zezë dhe të zezës e bardhë. Nuk është turp t'i bëhet vërejtje qeverisë për mosrealizimin e detyrave, ashtu si nuk është turp t'i njohësh meritat për punën pozitive që arrin.”<sup>5</sup>

Opozita në përgjithësi është përpjekur të parashtojë probleme të qeverisjes vendore, mbështetur në të dhëna konkrete për gjendjen në komuna, fshatra, si në rastet për Kryevindh të Kavajës, Rrebeke të Shijakut, për fshatra të Dibrës, Përmetit, etj. Madje të dhënat që sillen janë mjaft konkrete dhe për ndodhi e persona të veçantë. Po ashtu janë paraqitur të dhëna për sjelljen e prefektëve, e të nëpunësve të qeverisjes qendrore. Mund të përmendim këtu kritikën për mbylljen e shumë shkollave në fshatra. në emër të cilësisë. Deputeti opozitar, Ali Këlcyra, në një nga seancat me debat, theksonte se, Kryeministri Z. A. Zogu, pati premtuar se qeveria e tij do të përdorte mjetet më të forta për të arritur zhvillimin arsimor dhe integrimin në botë. “Një shok, - vinte në dukje ai, - pat thënë se do të ishte ai i pari që do t'i jepte votëbesimin nëse do respektohej programi i shpallur. Por ky premtim jo vetëm nuk u mbajt, por u mbyllën më shumë se 100 a 200 shkolla. Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit nuk qe i zoti të na e tregonte numrin real të shkollave të mbyllura. Ne jemi informuar nga inspektorët e drejtuesit e shkollave”. “Në politikë, - vazhdonte ai, - nuk është e thënë se duhet të mbahen premtimet pikë për pikë. Politika do të kishte një drejtësi të palëkundur nëse do i përmbahej programit. Programin e kryeministrit Z. A Zogu unë e mbështes, por duke qenë se në zbatimin e tij ka imoralitet, ai e ka humbur besimin e popullit”.<sup>6</sup>

Veçoria e veprimtarisë së parlamentit është shfaqur edhe nëpërmjet shkallës së diskutimeve, të argumenteve rreth tyre. Kështu, për një periudhë të gjatë objekt diskutimi ka qenë ai i raportit ndërmjet:

- Sigurisë dhe rendit të qëndrueshëm.
- Ngritjes së nivelit të jetesës së popullsisë.
- Në diskutimet janë vënë në dukje arritje si:
- Qeveria bëri një shërbim të madh në çështjen e çarmatimit.

Historia shqiptare do të dijë ta vlerësojë paanësisht këtë vepër të madhe dhe ata që bënë të mundur realizimin e saj.<sup>7</sup>

5 Po aty, f. 120.

6 Po aty, f. 124.

7 Po aty, f. 136.

• Gjithashtu, qeveria e sotme ka një meritë të posaçme për themelimin e arsimit kombëtar si laik. Megjithatë, kanë ekzistuar disa zëra që kanë synuar që feja të depërtojë në shkolla, duke arsyetuar se nga pikëpamja e moralit mësimi fetar është i frytshëm.<sup>8</sup>

Sigurimi i rendit, sipas deputetëve, kërkonte si përkushtim ashtu edhe gjendjen e mirë ekonomike. “Por, të dyja këto plotësojnë njëra-tjetrën. Nuk mund të ketë qetësi nëse populli nuk ka të hajë e të vishet. Gjithashtu, gjendja ekonomike nuk mund të jetë e mirë pa siguruar qetësinë, mungesa e saj do të sillte mungesën e investimeve të huaja dhe nga ana tjetër nuk do të mundte të depëronte as kapitali i vendit”.<sup>9</sup>

Por të dy drejtimet bazë në funksionimin e shtetit, janë bërë objekt diskutimi edhe rrugët, mjetet dhe format e përdorura nga qeveria. Kështu, deputetët e opozitës nuk janë pajtuar me “sigurimin e qetësisë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të dhunshme”.

Këtë e deklaroi L. Gurakuqi: “Një qeveri ka dy mënyra për të mbajtur qetësinë, brutalitetin ose ligjin”.<sup>10</sup>

Kështu, theksi i kërkesave të opozitës është vënë në :

• Përdorimin e ligjeve dhe të edukimit të popullit nëpërmjet zbatimit të ligjit.

• Ndërmarrjen e reformave për ngritjen e shkallës së jetesës.

• Rritja e shkallës së arsimit.

Thonë se qetësia është e domosdoshme për mbarëvajtjen e kombit, por ka edhe plot mënyra të tjera për ta arritur këtë. Njëra nga këto është shkolla. Duhet t’i mbushim mendjen shqiptarit që të jetë i bindur në respektimin e ligjit e të bashkëpunojë për vëllazërim e atdhe. Mjerisht, dua të them se që nga viti 1912 e deri më sot, nuk ka gjetur asnjë mbështetje për ta drejtuar në udhën e duhur. Këtu flas edhe për veten time, si ish drejtues i këtij dikasteri.<sup>11</sup>

Mund të themi se diskutimet për zhvillimin e arsimit janë mbizotëruese. Tek zhvillimi i arsimit shihej:

• Formimi kulturor i popullsisë, brumosja e saj me ide dhe ideale të demokracisë.

• Rritja e profesionalizmit si domosdoshmëri për zhvillimin e ekonomisë.

8 Po aty, f. 137.

9 Po aty, f. 157.

10 Po aty, f. 126.

11 Po aty, f. 130.

- Shëndoshjen e familjes mbi bazën e marrëdhënieve të reja.

Përmirësimi i gjendjes ekonomike në familje që ka lidhje të fortë me zakonet dhe nevojat e fshatarit, mund të vijë vetëm me zgjimin e kombit dhe me anë të arsimit dhe jo me një frymë apo një makinë, se njerëzit ideal nuk prodhohen në fabrikë si i do zotëria e tij.<sup>12</sup>

Nga diskutimet në parlament sillen fakte që lidhen me shkallën e përgjegjësive të nëpunësve të qeverisë dhe të realizimit të funksioneve të tyre me korrektësi, pa përfitime të interesit personal. Qëndrimet e tyre nuk mund të shkëputen nga konteksti i karakterit të marrëdhënieve ekonomike e sociale, të shkallës së kulturës politike të drejtuesve të organizmave të shtetit dhe të kulturës së masës popullsisë.

Funksionimi i qeverisjes mbi bazën e ligjit, ashtu siç e kemi përmendur, pengohet nga prania e marrëdhënieve klienteliste të përmendura nga bajraktarizmi. Kjo lehtësonte veprime të nëpunësve mbi bazën e interesave të ngushta, të marrëdhënieve fisnore e personale dhe për shkelje në zbatimin e ligjeve. Është pranuar ekzistenca e një kontradikte ndërmjet:

- Miratimit të ligjeve që i përmbahen zgjedhjes së çështjeve të mprehta.

- Zbatimit të tyre me përpikmëri, korrektësi dhe efektshmëri.

Ndërkohë janë projektuar ndërmarrja e masave të efektshme si, për shembull për zhvillimin e arsimit nuk janë marrë masa për realizimin e tyre me shpenzimet e duhura. Kështu, mbyllja e shkollave (rreth 100) u shpjegua me tri arsye:

- Nga mungesa e mësuesve të kualifikuar.
- Nga mungesa e të ardhurave për t'i mbajtur hapur.
- nga gjendja e vështirë financiare në pamundësi për t'i realizuar, gjithashtu, menduam të bënim diçka edhe në prefekturën e Dibrës dhe të Kosovës, ku një vit më parë nuk ekzistonte asnjë shkollë.<sup>13</sup>

Ndërkaq, përpjekjet në këtë drejtim i lihen edhe spontanitetit. Shpresojmë se do të kemi shkolla vetëm kur të kemi siguruar një staf të kualifikuar dhe kur të bindemi se duhet të fitojmë një kulturë të plotë dhe jo sa për të mësuar abecën.<sup>14</sup> Kjo mund të shpjegohet në radhë të parë me mos funksionimin sa duhet i aspekteve të tjera qeverisëse si:

12 Po aty, f. 143.

13 Po aty, f. 152.

14 Po aty.

- Përgjegjësia në qeverisje.
- Kontrolli dhe llogaridhënia.
- Shkalla e përgatitjes profesionale të nëpunësve.

Në diskutime të deputetëve të opozitës vihen në dukje në mënyrë të veçantë përpjekjet për të patur qeveri të fortë, që sipas Fan Nolit, duhen kërkuar në dëshirën e përgjithshme për një qeveri të fortë dhe me besimin se vetëm një qeveri e fortë mund t'i zgjidhë problemet e koklavitura të Shqipërisë e t'i vendoste shtetit shqiptar themele të patundura me një organizim modern.<sup>15</sup> Por, njëkohësisht vihet në dukje përlindja e shfaqjeve autoritariste me kryeministër, që e dominuar. Të forta kanë qenë këto qeveri pa fjalë. Një ish-kryeministër dhe tani një kryeministër që i impononte kabinetit vullnetin e tij me një parlament ideal, të dominuar nga një shumicë përkatëse, besnike dhe të disiplinuar. Sa për kohën, një vit e ca muaj më shumë, ishin mjaft për të bërë, në mos shumë, diçka, e në mos gjëra të mëdha, të paktën ca gjëra të vogla. Shpresat ishin të mëdha për rezultate të shkëlqyera e të shpejta.<sup>16</sup> Ndërkaq, ka shqetësime për shfaqjen e prirjeve të tilla. Zhgënjimi, deklaronte F. Noli është i plotë. Dhe shpjegohet lehtë. Populli priste shumë, edhe gjëra të mëdha, por qeveritë tona të forta nuk bënë as të vogla. Përse? Sepse një shtet nuk organizohet me forcë, por me forcë dhe dije, forcë dhe zotësi, forcë dhe kanun, cilësi që i'u mungonin kabineteve tona “të forta”. Por kështu, këto s'bëjnë gjë tjetër veç të përsërisnin në Shqipëri historinë e qeverive të forta primitive, ballkanike, të vetëquajtura parlamentare.<sup>17</sup>

Kjo është arsyeja që në të ardhmen, në procesin e zhvillimeve në aspektin e qeverisjes, u bë diferencimi ndërmjet:

- Përkrahësve të një qeverie sa më autoritare e shoqëruar edhe me forcimin e qendërsimit të pushtetit të qeverisë qendrore.

- Përkrahësve të zhvillimit të jetës parlamentare, si kusht që Medi Frashëri e shpall si një “votëbesim dy llojesh”. Votëbesimi i parlamentit për qeverinë dhe votëbesimi i popullit për parlamentin.

Kjo është si djathi me kripë. Besimi i parë është djathi, i dyti kripa. Derisa të priset djathi, kemi kripën, por kur të priset edhe kripa atëherë si i bëhet hallit?<sup>18</sup>

15 Po aty, f. 139.

16 Po aty.

17 Po aty.

18 Po aty, f. 167.

Sidoqoftë, mbizotëruese do të bëhet prirja e parë. Kjo shpjegohet me ndryshimet në formën e qeverisjes, të kalimit nga Republika në Monarki. Me gjithë këto zhvillime, jeta parlamentare siç e kemi trajtuar në krerët e mëparshëm, ka luajtur një rol vendimtar për qeverisjen. Në parlament janë realizuar debate dhe janë miratuar ligje të drejtpërdrejta për qeverisjen vendore. Për më tepër, ndryshimet në legjislacionin e administratës qendrore janë pasuar me ato të administratës vendore. Kështu, ka ndodhur me projektligjin e administratës qendrore të vitit 1929 të cilit i bashkangjitej ai i komunave. Ndërkohë, është mbajtur parasysh përvoja edhe e shteteve të tjera, e shprehur nëpërmjet dy sistemeve:

- Organizimi i komunave në një administratë të decentralizuar pa pasur asnjë diferencë midis katundeve, qyteteve dhe kryeqyteteve.

- Organizimi i komunave në një administratë të decentralizuar por pa i shkëputur marrëdhëniet midis organizatës së katundeve dhe qyteteve dhe këtyre të fundit me kryeqytetet.<sup>19</sup>

Lidhur me pranimin e sistemit të dytë, me administratë të deqendëruar, janë sjellë argumente në bazë të të cilave, gjendja social-ekonomike dhe nevojat e qyteteve të vendit tonë nuk mund të krahasohen me nevojat e fshatrave të braktisur. Projekt-ligji për bashkitë e kryeqytetit dhe qyteteve ka lënë në fuqi dispozitat e ligjit komunal dhe për komunat që përbëhen nga disa fshatra, ka vënë në çdo kapitull dispozita të veçanta sipas situatës dhe nevojave të tyre. Kështu, ka përmbledhur të gjithë dispozitat relative në kapituj të veçantë, ashtu siç e kanë të gjithë ligjet komunale të shteteve të tjera.<sup>20</sup>

Një karakterizim tjetër ka të bëjë me shqyrtimin në vazhdimësi të funksionimit të qeverisjes vendore. Mbi këtë bazë janë bërë ndryshime të herëpashershme për mjaft çështje që lidhen me të drejtat dhe detyrat e organeve.

Nëpërmjet tyre është synuar që të bëhen përshtatje në organizimin e qeverisjes në bazë të ndryshimeve si në përbërjen e popullsisë e të zhvillimeve në gjirin e saj, të ndryshimeve në pasuritë dhe në zhvillimin e burimeve kapitale.

---

19 *Bisedimet e Parlamentit*, Mbledhja e XXXII, 18 Mars 1929, f. 150.

20 Po aty.

## 1. Veprimtaria praktike në pushtetin lokal (financat)

Financat e bashkive zënë vend të veçantë në Ligji.

Ligji përcaktonte të ardhurat dhe mënyrat e realizimit të tyre. (Artikulli 104-107). Në të thuhej se: të ardhurat e Bashkisë sigurohen nga qiratë e pasurive të paluajtshme që i përkasin kësaj Bashkie, si edhe nga fitimet e marra nga shitjet e këtyre pasurive me vendim të Këshillit Bashkiak. Të ardhurat siguroheshin edhe nga fondet e mbetura nga rregullimi i rrugëve që ndodheshin brenda në qytet apo nga dhuratat që i bëheshin Bashkisë nga qytetarët në mbarë botën.

Njëkohësisht, të ardhurat siguroheshin nga vjelja e taksave për shërbimet që Bashkia ua ofronte qytetarëve si drita, ujë etj.<sup>21</sup>

Taksat përbënin burimin kryesor të të ardhurave. Ato ishin të ndara në taksa qeveritare dhe taksa të bashkisë. Këto të fundit ishin llogaritur si taksa shtesë.

Ndërkaq, ishin mjaft të detajuara subjektet e vjeljes së taksave që nga tregtarët e zejtarët për veprimtarinë e tyre, si dhe për urat, depot e ngritura, thertoret, regjistrimi i mjeteve të transportit, për gjënë e gjallë që zotëronin qytetarët (Artikulli 109 - 147).

Po ashtu ishin përcaktuar edhe kriteret e shpenzimeve të bashkive. Ato vendoseshin nga Këshilli Administrativ dhe kontrolltoheshin nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave (Artikulli 148 - 150).

Është për t'u shënuar hapësira e krijuar në zbatimin e ligjit të Bashkisë e të rregulloreve të nxjerra prej saj, ku përfshihen detyrat e mjekëve, të pastruesve, të hotelexhinjve, furrxhive, mitanexhive, kasapëve, të qumështoreve, të gjellëtove, bakajve, berberëve, kafexhinjve, hanxhive.<sup>22</sup> Në përgjithësi ato përmbanin kërkesa për plotësimin e disa kriterëve që janë pjesë e rregullimit e të kontrollit për të realizuar shërbimet e përshtatshme për konsumatorët e shtetasit në tërësi.

21 AQSH, Ligji i Bashkive, Ministria e Punëve të Mbrendëshme Nr. 2560-II, 1921.

22 Po aty, Dokumenti 1401 – I, 1743 – I, 1876.

Në përputhje me ligjin miratohej Rregullorja e Shtetit Civil. Rregullorja vendoste për realizimin në mënyrë të studiuar i regjistrimit të popullsisë me të gjitha të dhënat demografike dhe identifikimi nëpërmjet letërnjoftimit. Ajo përmbante mënyrat e organizimit të regjistrimit, nëpunësit përkatës, komisionet e caktuara. Regjistrimi ishte i detyrueshëm.<sup>23</sup>

Në shtypin e kohës të bie në sy problematika e gjerë me temë qeverisjen vendore. Janë botuar për shembull, qarkoret e ndryshme që bënin fjalë për zgjedhjen e kryepleqve të fshatrave. Nëpërmjet tyre synohej jo vetëm njohja e shtetasve me dokumentacionin, por edhe sensibilizimi për përgjegjësitë e tyre si në rastin e zgjedhjeve. Kërkohej, për shembull, që në zgjidhjen e tyre të kiheshin parasysh kriteret për të zgjedhurit, si: të ishin njerëz të ndershëm, të zotë, me moral e karakter të mirë, atdhetarë e me një të shkuar të mirë.<sup>24</sup>

Po ashtu, në shtyp trajtohen problemet e vështira ekonomike dhe mos- përballja e duhur nga organet vendore. Kështu në artikullin “Shtrenjtësia dhe Bashkitë” shkruhej se populli nuk ngopej me premtime, “por pret realizimin e tyre”.<sup>25</sup>

Por elita intelektuale e kohës nuk mjaftohet vetëm me vërejtje dhe kritika. Nëpërmjet debatit në shtyp, ajo ofronte zgjidhje për problemet që shqetësonin banorët.

Është për t'u theksuar se mbizotëronte mendimi që të ndërhyhej në legjislacion për një decentralizim të mëtejshëm të pushtetit. Kështu, në artikullin e dt. 16 qershor 1923 të gazetës “Shqiptari i Amerikës” nën titullin “Centralizimi Administrator” shkruhet: “Urdhrat e qeverisë janë shumë lark të duken kështu si një nevojë për çdo vent dhe kështu vjen një mos kënaqësi ku se ndryshe lipset në Vlorë dhe ndryshe në Dibër që të miren masat e duhura.”<sup>26</sup>

Prandaj kërkohej që centralizimit të pushtetit t'i jepej fund sa më parë.

Shkrimi vazhdonte me shembuj prej shteteve të Amerikës së Veriut, të Gjermanisë, Francës, ku thuhej se, “qeverisja vërvitet si akrepat e orës rreth një pike ku çdo lëvizje ka punën dhe veprimtarinë e vet”.<sup>27</sup>

23 Po aty., Fondi 146, viti 1922, dosja 5, f. 75 – 80.

24 *Shqiptari i Amerikës*, Korçë, 10 shkurt 1923.

25 Po aty, 17 shkurt 1923, f. 4.

26 *Shqiptari i Amerikës*, Korçë, 16 qershor 1923, f. 5.

27 Po aty.

Ngjarjet e qershorit të vitit 1924, formimi i qeverisë së re me Fan Nolin në krye nuk patën ndonjë ndikim të madh në strukturën e qeverisjes vendore. Kjo ndodhi për shkak të afatit kohor tepër të shkurtër të ekzistencës së qeverisë, nga mosrealizimi praktik i reformave të rëndësishme të projektuara prej saj dhe nga që qeveria nuk u përpoq të siguronte legjitimitetin e saj nëpërmjet zgjedhjeve të reja.

Sidoqoftë u arritën të miratohen dekretligje që synonin për forcimin e organeve të qeverisjes vendore dhe për t'i bërë ato sa më të përgjegjshme. Kështu, sipas dekretit të Këshillit të Lartë të Shtetit Shqiptar të 11-VIII-1924, të firmosur nga kryeministri F.S.Noli, vendimet e Këshillit Administrativ të Prefekturave ose Nënprefekturave apeloheshin përpara gjyqit të shkallës së parë të secilës prefekturë.

Ndërkaq nuk u realizua një nga pikat e programit të kabinetit qeveritar ku synohej organizimi i komunave për të përmirësuar gjendjen e katundeve e të katundarëve me kompetencë të gjerë mbi çështjet lokale.

Me sa duket synohej për zbatimin e masave, pjesë të dependëzimit. Por duhet theksuar se në këtë periudhë me gjithë problemet politike qytetet e Shqipërisë u kthyen në këto vite në qendra të rëndësishme, ku rrethet demokratike dhe arsimtarët luftuan për progresin e shkollës dhe laicizmin e saj.

Prof. ass. dr. Teki KURTI

## SUMMARY

### **PARLIAMENTARY ACTIVITY AND GOVERNANCE BETWEEN 1920 AND 1924 IN ALBANIA**

Analysis of governance from the perspective of parliamentary activity is of particular importance for understanding the country and its governing model. Such analysis is very necessary in countries with liberal democratic system of governance enforced through representative government initially realized in parliament.

Parliamentary activity in Albania in its very beginning characterized by important activity in accomplishing the parliamentary function as the institution for policy review and debate.

This important aspect of governance has served the country. Since the first legislation there was an opposition present, although its level of organization and influence not satisfactory. However, its prominent members have been Luigj Gurakuqi, Haxhi Banka, Bari Omari, Ali Këlcyra, Fan Noli.

